

Lajmet e Fundit: Kukës – U denoncua në faqen zyrtare të DVP Kukës, për përndjekje, Policia pas hetimeve të kryera vuri në pranga 22-vjeçarin

⏏ ⏪ ⏩



06/02/2021

Durrës – Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje dhe shpërndarjes së drogave të forta. Finalizohet operacioni policor i koduar “Nënkalimi”.

Qarkullonte me armë zjarri dhe me doza kokaine gati për shitje, arrestohet në flagrancë 29-vjeçari.

29-vjeçari i dënuar më parë në Gjermani, për trafikim të lëndëve narkotike.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë dhe një sasi lënde narkotike kokainë.

Në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, si rezultat i kontrolleve të shtuara për kapjen e personave më kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri me vete apo që ushtrojnë veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve, specialistët për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Forcën Operacionale në DVP Durrës, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative për një shtetas që qarkullonte me armë zjarri pa leje dhe ushtronte veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së drogave të forta, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Nënkalimi”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

Sh. H., 29 vjeç, banues në Maminas, Durrës, i dënuar më parë në Gjermani, për trafikim të lëndëve narkotike.

Në vendin e quajtur “Ura e Dajlanit”, shërbimet e Policisë kanë ndaluar mjetin tip “Volkswagen” me drejtues shtetasin Sh. H.

Gjatë kontrollit të automjetit me të cilin qarkullonte ky shtetas, Policia gjeti një armë zjarri, 1 krehër me 6 fishekë, lëndë narkotike të dyshuar kokainë dhe tre aparate celular, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale së bashku me automjetin tip “Volkswagen”.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linge

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent

◀ Vlorë, Sarandë – Policia vë në pranga 4 shtetas, njëri prej tyre i shpallur në kërkim.

Interpol Tirana – Falë bashkëpunimit të ZQK Interpol Tirana me zyrat homologe janë ekstraduar 3 shtetas të shpallur në kërkim ndërkombëtar ▶